



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

SCC-10-0281

Paditësit

- 1. B H**
- 2. F H**
- 3. R H** që të tre trashigimtarë të të ndjerit F H nga M
Përfaqësuar nga av. B Xh nga M

Kundër

Te paditura

- 1. NSH “Mirusha” Malishevë**
përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)**, Rr. Dritan Hoxha 55 Prishtinë.
- 2. K e M –M**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), Kolegji i përbërë nga Diellza Hoxha gjyqtare kryesuese ,Gazmend Sylaj dhe Sylejman Shumolli gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse me datë 23 Mars 2023 , lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Padia paditësve në lidhje me ngastrat nr.135 dhe nr.113 që gjenden në vendin e quajtur “S” Zona Kadastrale M refuzohet për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv.**
- 2. Padia e paditësve ne lidhje me një pjese të ngastrës nr.4-2 dhe nr. 56-1 refuzohet si e pabazuar.**
- 3. Secila palë do ti paguaj shpenzimet e veta .**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 20 shtator 2006, paditësit ne fillim kanë dorëzuar padi në Gjykatën Komunale në Malishevë kundër të paditurave N “M”-M, dhe Komunës së M me të cilën kërkuan që të vërtetohet e drejta e

pronësisë në ngastrat kadastrale NK nr.4 ne sip.1.07.13 ha dhe NK nr.121 në sip.1.39.00 ha dhe NKnr.135 në sip. prej 1.39.00 ha në vendin e quajtur “D” Z K M (prona kontestuese).

Me aktvendimin C.nr. 240/2006 të datës 12.08.2010 Gjykata Komunale në Malishevë, ishte shpallur in kompetente në këtë çështje juridike. Shkresat e lëndës me aktin përcjellës të datës 24.09.2010, e dërgoi në Dhomën e Posaçme, lënda u evidentua nën numrin SCC-10-0281.

Paditësit ne padi theksojnë se janë pasardhësit e F H ish nga M i cili ka qenë pronar i pronës kontestuese deri në vitin 1963. Në vitin 1963, paraardhësit të tyre ju kishin marr pa baze juridike ngastrat dhe iu kishin bashkuar kompleksit tokësor sipas planit të atëhershëm agrobujqësor dhe u evidentuan në emër të shfrytëzuesve të ndryshëm juridik ku fillimisht iu bartën në pronësi Kooperativës bujqësore O “P” pastaj “O”- Rahovec dhe tani gjinden të evidentuara në emër të paditurës NSH “M” si pjese e ngastrave nr.4/2 vendi “Rr-S” dhe nr.56 vendi “S” fletë posedimi fletë posedimi UL-72310047- 87 ZK Malisheve. Me tej paditësit pohuan se paraardhësi i tij kishte kundërshtuar marrjen e ngastrave, por duke pasur parasysh natyrën e sistemit politik të asaj kohe ka qenë i penguar që të ushtrojë të drejtën në mbrojtjen juridike të të drejtës së tij pronësore. E paditura që nga viti 1990 e ka lëshuar nga posedimi dhe nga ajo kohë pronën kontestuese e posedojnë dhe e shfrytëzojnë paditësit pa shqetësim dhe pa u penguar nga ana e të paditurës.

Me 1 nëntor 2010, Dhoma e Posaçme lëshoi urdhër për paditësit, me të cilën kërkoi përkthimin e të gjitha dokumenteve të dosjes së Gjykatës Komunale në Malishevë me nr. 240/2006, padinë të korrigjuar dhe të kompletuar, përkthimin në gjuhën angleze të padisë, aktvendimin e trashëgimisë për paraardhësin e tyre.

Me 24 shtator 2012, paditësit u përgjigjën në urdhrin e gjykatës dhe dorëzuan padinë dhe shkresat përcjellëse të lëndës, të përkthyer në gjuhën angleze.

Me 9 janar 2017, Dhoma e Posaçme lëshoi aktvendim me të cilin padia dhe dokumentet mbështetëse të paraqitura së bashku me të në këtë rast të i dorëzohen të paditurave Komunës së Malishevës dhe AKP-së si administrator i NSH-së.

Me 6 mars 2017, AKP parashtroi mbrojtje në padi në të cilën pohoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësve të paraqitura në padinë e tyre, duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj. AKP-ja ka kontestuar legjitimitetin aktiv të palëve, AKP-ja theksoi se paditësit në padi nuk e ka theksuar bazën juridike në të cilën e mbështet kërkesëpadinë, nga kjo rrjedh se padia është parashtruar në kundërshtim me nenin 27 parag. 4 i pikës 2 të Shtojcës së Ligjit DHPGJS nr. 04/L-033 dhe nenit 253 të LPK nr. 03/L-006 pasi që kërkesa nuk përmban argumente ligjore në të cilën mbështetet për të drejtën e pretenduar. Në lidhje me pretendimet se pasuria është transferuar në pronë publike pa baza ligjore, citohet neni 268 i Ligjit mbi Punën e Bashkuar, i cili parashikon që kthimi i saj mund të kërkohet brenda afatit 5 vjeçar duke filluar nga dita e njoftimit dhe më së voni brenda afatit 10 vjeçar. Prandaj, mbi këtë bazë është parashtruar kërkesa për kthimin eventual të pasurisë së paluajtshme përmes procedurës gjyqësore. E paditura me tej pohoi se paditësit nuk ka paraqitë asnjë provë të vetme të besueshme se a ka kërkuar ndonjëherë paraardhësi i tyre pronën kontestuese deri në parashtrimin e padisë. Lidhur me pretendimet e paditësve se e posedojnë dhe e shfrytëzojnë pandërprere pronën kontestuese AKP-ja e kundërshton duke theksuar se posedimi nuk është bazë ligjore për fitimin e pronësisë në kuptim të nenit 29 të LMTHPJ nr.6/80. Nga të gjitha këto AKP-ja propozon që padia të refuzohet si e pa bazuar.

E paditura e dytë Komuna e Malishevës edhe pse ka pranuar padinë e paditësve nuk është përgjigjur asnjëherë me shkrim.

Me 18 prill 2017 gjykata lëshoi urdhrin me të cilin ka kërkuar aktvendimin e trashëgimisë për të ndjerin F H.

Me 12 maj 2017 paditësit parashtruan parashtrësën për rregullimin e legjitimitetit të palëve ngase dy nga paditësit H dhe J H kishin vdekur dhe për kane parashtruar aktvendimet e trashëgimisë.

- Kopjen e aktvendimit të lëshuar nga Gjykata Komunale Malisheve Tnr.14/2002 të datës 15.04.2002 për të ndjerin F H me të cilin janë shpallur trashëgimtar H J dhe B H.
- Kopjen e aktvendimit të lëshuar nga GJKM Tnr.52/2010 të datës 28.02.2011 për të ndjerin J H me të cilin ishte shpallur si i vetmi trashëgimtar F H.
- Kopjen e aktvendimit të lëshuar nga ana e noterit I E me nr. LRPnr.4203/2014 REF Tnr.1204/14 për të ndjerin H H ku si trashëgimtar i vetëm është shpallur R H.
- Autorizimin e dhënë av B Gj nga dy paditësit. (B dhe F H)
- Me 6.12.2022 Parashtrësën gjegjësisht një historiat të përpiluar në vend nga një Ekspert i Kompanisë së licencuar M& M GEO Grup SHPK të cilin e kishin angazhuar paditësit.

Me datë 20 qershor 2017 nga kolegji i atëhershëm kishte caktuar një seancë dëgjimore, por ishte shtyrë për shkak se avokatja nuk kishte autorizimin për paditësin R H.

Ne seancën e datës 14.04.2022 nuk ishte prezent përfaqësuesi i Komunës së Malishevës edhe pse ishte ftuar në mënyrë të rregullt.

Ne seancën e datës 14 prill 2022 përfaqësuesja e paditësve theksoi se mbetet pranë kërkespadiës së parashtruar në fillim por edhe pranë parashtrësës të dorëzuar në Gjykatën Komunale në Malisheve në bazë të së cilës paditësit kanë bërë zgjerimin e objektit të padisë, ku përveç ngastrave nr.4,nr.12,nr.1 kanë kërkuar vërtetimin e të drejtës pronësore edhe në ngastrën me nr.61 vendi i quajtur “D” në sipërfaqe prej 80 ari dhe ngastrën me numër 113 në sipërfaqe prej 1 hektar e 29 ari që të dyja të evidentuara në fletë poseduese nr.16 ZK Malishevë. Paditësit pretendojnë se janë bashkëpronarë me nga 1/3 të sipërfaqes së ngastrave që janë objekt i padisë. Ngastrat në vitin 1963 pa bazë juridike dhe pa as një kompensim i janë marrë të ndjerit paraardhësit të tyre edhe fillimisht në mënyrë administrative u janë bartur në pronësi të Kooperativës bujqësore O P mandej në NSH “O” R dhe në fund në emër të paditurës NSH “M”. Por për ta vërtetuar këtë fakt se pronat e pretenduara kanë qenë prona të paditësve përfaqësuesja ka kërkuar nga gjykata që sipas detyrës zyrtare të kërkojë nga Komuna e Malishevës një historiat që të vërtetohet se me çfarë baze kanë kaluar këto prona në emër të ndërmarrjes.

Përfaqësuesi i AKP-së lidhur me kërkesën e përfaqësueses për historiat theksoi se sipas konfirmimit të Zyrës rajonale ngastrat e kërkuara në parashtrësën për zgjerim të padisë ngastrat N.6 dhe NK nr 11 nuk evidentohen në emër të NSH -së, ndërsa sa i përket padisë bazë ngastrat figurojnë edhe tani në emër të NSH-së. AKP-ja njoftoi gjykatën se paditësit kanë bërë kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit ku kërkesa e tyre ishte refuzuar dhe nuk kemi shënim që është ankimi siç është parapa me nenin 37 të Shtojcës së Ligjit të AKP-se nga kjo rezulton që është lëshuar afati i ankimimit mund ta konsiderojmë si çështje të gjykuar.

Përfaqësuesi i AKP-së dorëzoi kopjen e vendimit PRZ008-0033 të datës 23.06.2014 me të cilin është refuzuar kërkesa e H H si e pavlefshme. Lidhur me pretendimet e paditësve se e posedojnë dhe e shfrytëzojnë pandërprere pronën kontestuese AKP-ja e kundërshtoi duke theksuar se posedimi nuk është bazë ligjore për fitimin e pronësisë në kuptim të nenit 29 të LMTHPJ nr.6/80. Me 23 shtator 2022 Gjykata lëshoi një urdher për Zyrën Kadastrale në Malisheve me të cilën ju kërkua që të parashtronte historikun e pronës kontestuese.

Me 17 tetor 2022 Zyrja kadastrale e Komunës së Malishevës parashtrori të dhënat kadastrale dhe historikun e pronës kontestuese. Sipas historikut ngastrale nr.4 në vendin e quajtur "Rreze" në vitin 1952 ka qenë e evidentuar në emër të F H sipas shënimeve të vitit 1959, ndërsa në vitin 1967 në skica plotësuese kjo ngastër dhe ngastrat tjera bashkohen dhe kalojnë në pronësi të O "M" për të cilat nuk posedojnë dokumenta se si ka kaluar në emër të NSH-së. Tani kjo parcelë është e ndarë në shumë pjesë dhe ka pronar persona privat në bazë të aktgjykimeve me të hershme kurse sipërfaqja e mbetur në pronësi të O M është 5,09.48 ha. Në kohën kur ka hy në fuqi operati teknik i aerofotografimit të vitit 1959 kjo ngastër është evidentuar me nr.56 ku ndër to është është përfshirë edhe parcela nr.61 ku sipërfaqja e përgjithshme prej 9.97.41 ha, kjo ngastër tani mban numrin 56-1 me sipërfaqe prej 8.09.96 ha është e regjistruar në emër të O M, ndërsa pjesa tjetër e sipërfaqes është në emër të T M dhe K Rr në bazë të aktgjykimit Cnr.118/2004. Ngastra 135 është e ndarë në dy pjesë dhe është në emër të personave privat ku janë bashkangjitur certifikatat, po ashtu edhe ngastra 113 është e ndarë në 3 pjesë dhe është në emër të personave privat për të cilat janë bashkangjitur certifikatat.

Me 6 dhjetor 2022 Përfaqësuesja e paditësve parashtrori një Historit të përpiluar sipas gjendjes në terren të përpiluar nga një ekspert i kompanisë së licencuar "M& M G G SH" të cilin gjykata i ka dërguar AKP-së.

Edhe në seancën e fundit me 21 shkurt 2023 përfaqësuesi i Komunës nuk prezantoi edhe pse ishte i ftuar në mënyrë të rregullt dhe nuk kishte arsyetuar prezencën e tij.

Në seancën e fundit në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e paditësve mbeti pranë padisë dhe deklarimeve të saj në seancat e kaluara ku në bazë të provave dhe historiatit të dorëzuar në gjykatë kërkoi nga gjykata që paditësve të ju njihet e drejta e bashkëpronësisë në sipërfaqen e ngastrave të kërkuar dhe të detyrohet e paditura që tua kthej dhe të lejoj regjistrimin e këtyre pronave në emër të tyre.

Përfaqësuesi i AKP-së mbeti pranë mbrojtjes dhe të gjitha kundërshtimeve në seanca të kaluara. Lidhur me pretendimin e paditësve se prona është marr pa asnjë bazë ligjore në vitin 1963 ai parashtrori një kopje të Vendimit të Komisionit nr.1062-1069 të lëshuar nga Komuna e Malishevës me datë 24 nëntor 1963 ku paditësve nuk ju ka njohur e drejta e pronësisë për ngastrat 135 dhe 121 ndërsa i është njohur për ngastrat nr. 61 dhe nr.113. Por ky vendimi nuk dihet a është i plotëfuqishëm. AKP-ja ritheksoi se edhe në Autoritet të likuidimit është refuzur kërkesa e paditësve dhe për të nuk kanë bërë ankesë, po ashtu ritheksoi lidhur me pretendimet e paditësve se e posedojnë dhe e shfrytëzojnë pandërprerë pronën kontestuese AKP-ja theksoi se posedimi nuk është bazë ligjore për fitimin e pronësisë shoqërore në kuptim të nenit 29 të LMTHPJ nr.6/80. Gjykatës i propozoj që padia e paditësve të refuzohet si e pabazuar.

Arsyetimi Ligjor

Paditësit kërkuan nga gjykata që të ju njihet e drejta e bashkëpronësisë në sipërfaqen e një pjese të ngastrës 4-2 dhe një pjese të ngastrës 56-1 si dhe ngastrave 135 dhe 113 ZK Malishevë. Të detyrohet e paditura të ju njeh të drejten e pronësisë dhe të lejoj regjistrimin e këtyre pronave në emër të tyre.

Kolegji pas shqyrtimit të padisë provave të ofruara në seanca nga të dyja palët si dhe nga Historiati i dorëzuar nga Zyrja kadastrale e Komunës së Malishevës konkludon se:

Padia kundër NSH (O) Mirusha –lidhur me ngastrat kadastrale 135 dhe 113

Nga dokumentet e paraqitura nga Zyra Kadastrale e Komunës së Malishevës, kolegji konkludon se ngastrat 135 (e ndarë në dy pjesë 135/1 dhe 135/2) dhe ngastra 113 (e ndarë në tri pjesë 113/1, 113/2 dhe 113/3) nuk janë të regjistruara në emër të paditues, ato në bazë të Aktgjykimeve të Gjykatës Komunale në Malishevë janë të regjistruara në emër të personave të tretë për të cilat janë parashtruar çertifikatat e pronësisë. Prandaj, të paditues i mungon legjitimiteti pasiv për padinë në lidhje me këto ngastra kadastrale.

Prandaj, u vendos si në dispozitiv.

Padia kundër NSH(OP) Mirusha lidhur me një pjesë të ngastrave 4-2 dhe 56-1

Gjykata nga të gjitha argumentet e parashtruara dhe të deklaruara nga palët, nga Historiati i parashtruar në rastin në fjalë, konkludoi se ajo çfarë është e rëndësishme është fakti se tokat janë të regjistruara në emër të paditurës qysh nga viti 1963 . Bazuar në vendimin e organit administrativ Vendimit të Komisionit nr.1062-1069 të lëshuar nga Komuna e Malishevës të datës 24 nëntor 1963 mbi të cilat e drejta e pronësisë është fituar në pajtim me ligjin.

Paditësit pretendojnë të drejtën e pronësisë të cilën sipas tyre këtë pronë e kanë mbajtur në posedim dhe e kanë ushtruar pushtetin e lirë në mënyrë publike dhe të papenguar nga e paditura qysh nga viti 1990.

Parashkrimi fitues ndaj pronave shoqërore

Paditësit pretendojnë të drejtën e pronësisë të cilën sipas tyre e kanë fituar me parashkrim fitues, pasi që këtë pronë e ka mbajtur në posedim dhe e ka ushtruar pushtetin e tyre të lirë në mënyrë publike dhe të papenguar qysh nga viti 1990.

Kolegji konsideron se posedimi i sendit me mirëbesim gjithashtu duhet të jetë njëri prej kushteve që duhet plotësuar për tu konfirmuar e drejta mbi pronësinë në sendin e paluajtshëm më parashkrim fitues (*bona fides*).

Posedim me mirëbesim (*bona fides*) kemi të bëjmë atëherë kur poseduesi nuk e dinë që sendin që e mban nuk është i tij, apo nga rrethanat e arsyeshme nuk kërkohet që të dijë se sendi që e mban nuk është i tij. Nga historati i dorëzuar nga Zyra Kadastrale shihet se prona kontestuese është e evidentuar në emër të O M si pronë shoqërore. Nga ana tjetër, gjithashtu, e drejta e pronësisë nga ana e NSH është fituar me punë juridike, me vendim administrativ qysh nga viti 1963, e që kjo tregon se paditësit nuk mund të konsiderohen si posedues të ligjshëm të pronës.

Andaj gjykata edhe përkundër pretendimeve të paditësit konsideron se nuk janë plotësuar kushtet të parapara sipas nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenin 54.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha Gjyqtare kryesuese

Gazmend Sylaj, Gjyqtar

Sylejman Shumolli, Gjyqtar
